



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 358/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet Vesel Krasniqi, nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019 në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa A.nr 358/2019 të datës 08.10.2019, të parashtruar nga Vesel Krasniqi, kandidati për deputet, nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, me të cilën ka kërkuar që të Urdhërohet KQZ-ja të bëjë rinuëmrimin e fletëvotimeve në Qendrat e Votimit: 3047A/01R shkolla fillore “Ruzhdi Xhyliqi” fshati Mirali dhe 30247A/01R shkolla fillore “Ramadan Morina” fshati Damanek në Komunën e Malishevës

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.10.2019, ka pranuar një ankesë Anr.358/2019 nga Vesel Krasniqi, në të cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit me nr. 3047A/01R, Shkolla Fillore “Ruzhdi Xhyliqi”, fshati Mirali në Komunën e Malishevës, Formularin e Rezultateve të Kandidatëve nuk i figurojnë asnjë votë edhe pse pretendon se është votuar nga 83 votues si dhe në Qendrën e Votimit me nr. 30247A/01R Shkollën Fillore “ Ramadan Morina” në Damanek Komuna e Malishevës, në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve i figurojnë 2 vota edhe pse pretendon Se ka fituar 72 vota, mirëpo gjatë regjistrimit te votave në formular janë bartur votat tek kandidati me nr. rendor 60.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultatit i cili është ende si rezultat

preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimeshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrahet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatit përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatit përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 358/2019 më datën 10.10.2019



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*